

VENDIM
Nr.18, datë 8.6.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Hilmi Dakli,	Anëtar i	"	"
Hajredin Fuga	Anëtar i	" "	
Zija Vuçi	Anëtar i	"	"
Franc Jakova	Anëtar i	"	"
Alfred Karamuço,	Anëtar i	"	"
Kujtim Puto	Anëtar i	"	"
Sokol Sadushi,	Anëtar i	"	"
Kristofor Peçi	Anëtar i	"	"

me sekretare Drita Filto më datë 27.5.1998 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.9 Akti që i përket:

KËRKUES: Xhyhere Belshaku e përfaqësuar nga avokat Spiro Vodica.

SUBJEKT I INTERESUAR: Xhulieta Vrahoriti përfaqësuar nga avokat Flutura Kona.

OBJEKTI:

Shpalljen antikushtetues të vendimit nr.1471, datë 24.9.1996 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe vendimit nr.1240, datë 27.10.1997 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit, sipas nenit 24, 25, 26 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 dhe nenit 16 të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi shpjegimet e palës kërkuese, subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin nr.1872, datë 05.07.1995 Gjykata e Rrethit Durrës ka rrëzuar padinë e Xhyhere Belshakut me objekt deklarin e pavlefshëm të kontratës së shitjes së bërë në favor të personit të tretë Xhuljeta Vrahorit për një apartament dhomë e kuzhinë. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.458, datë 31.01.1996 ka prishur vendimin e gjykatës së rrethit dhe ka pranuar padinë. Kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit, me vendimin nr.1471, datë 24.09.1996 ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit dhe ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit Durrës. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs Prokurori i Përgjithshëm, por Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit kanë vendosur mospranimin e tij.

Kërkuesia Xhyhere Belshaku i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me pretendimin se vendimet e kolegjit civil dhe Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit janë antikushtetuese, sepse i kanë mohuar asaj të drejtën kushtetuese për të patur një banesë. Në kundërshtim me sa parashtrohet kërkuesia, Gjykata konstaton se asaj nuk i është shkelur ndonjë e drejtë kushtetuese. Të drejtën që ia njeh ligji ajo e ka kërkuar në gjykatë dhe çështja është shqyrtuar në të gjitha shkallët e gjykimit, prandaj pretendimi se është shkelur neni 39 i Ligjit nr.7692, datë 31.03.1993 "Për një shtojcë në Ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" nuk qëndron.

Në këto kushte Gjykata çmon se kërkesa është e pabazuar dhe duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 24 e 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me shumicë votash,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIM I PAKICËS

Jam kundër vendimit të shumicës për këto arsye:

1. U vërtetua se fillimisht autorizimi i djalit të kërkueses ka qenë dhënë vetëm për 4 veta, djali me gruan e tij dhe dy fëmijët, duke mos u bërë fjalë për apartamentin e kërkueses që e kishte marrë me këmbim për arsye shëndetësore duke dhënë shtëpinë, pronë të saj personale;

2. U vërtetua se kërkuësja ka qenë e ndarë prej djalit;

3. Është e vërtetë se lejimi i këmbimit të banesës së saj private me apartament ishte bërë kur nuk kishte marrë djali apartamentin tjetër në saj të kontributit të vet, por zgjerimin e përfitoi ai që ishte vetë i katërt pa të ëmën që ishte e ndarë;

4. Autorizimin për dy dhoma + 1 kuzhinë djali e kishte marrë pa konditë që të lëshonte në dispozicion të ndërmarrjes apartamentin e së ëmës dhe as kjo nuk ishte pyetur dhe as kishte dhënë pëlqimin për zgjerimin e djalit me ato kushte. Si atëherë justifikohet zhveshja nga e drejta e saj e banimit dhe a nuk formon kjo një shkelje të një të drejte themelore?

ANËTAR

Hilmi Dakli